

Data 13/02/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE USHQIME DHE BUKE PER KOPSHTET DHE
CERDHEN PER VININ 2026**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 15800000-6,
15811100-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,875,000.00(njemilioneteteqindeshatatedhjetepesemije) lekë (Pa TVSH).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor _Bashkia Tropojë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 8, pika 1 ”Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit ”.

Ne hartimin e kriterëve për kualifikim, për objektin e prokurimit që përfshin furnizimin me produkte ushqimore, AK-ja ka përfshirë kërkesat e veçanta nga legjislacioni i fushës lidhur me disponimin e licensave dhe lejeve nga ana e operatorëve ekonomik ofertues.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë prokurim duhet që të plotësojnë kapacitet ligjorë, teknike dhe profesionale për kryerjen e këtij prokurimi.

Produktet ushqimore duhet të jenë konform standarteve teknike të përcaktuara në ligjin Nr.9863, datë 28.01.2008, “Për ushqimin”(I ndryshuar) si dhe akteve nenligjore të dala në zbatim.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit 2022,2023,2024. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

-
- a. Duke patur në konsideratë vlerën e objektit të prokurimit: **“Blerje ushqime dhe buke per kopshtet dhe cerdhen viti 2026”**, pika 3 e nenit 77 të LPP dhe sipas parashikimeve në nenin 43, pika 1 dhe 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar..”, si dhe mbi bazën e nenit 29, të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.”, si pika 1 dhe 2/c, në zbatim të nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe nenit neni 41, gërma ”c” të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”i ndryshuar.

2.2.2. Kopje e vertetuar te bilanceve te tre viteve te fundit (2022, 2023 , 2024) te paraqitur prane Administrates Tatimore te konfirmuar nga ky autoritet. *ku te paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit”*.

- a. **Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1.Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit **2022,2023,2024**. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a) dhe b, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë një automjet për kryerjen e furnizimit. Për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kopje të lejes së qarkullimit, siguracionit, pagimin e taksave vjetore, kryerjen e kontrollit teknik vjetor. Në rastin e disponimit të mjetit me qera duhet të paraqesë kontratën materiale të qerave.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetedeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetedeklarimit.

OE duhet të ketë pjesë të stafit teknik një numër prej 2 (dy) punonjësish për muajin e fundit (**dhjetor 2025**), ku njëri duhet të jetë patjetër shofer, i pajisur me leje drejtimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij për të kërkuar që operatori ekonomik ofertues të disponojë një automjet për transportin e mallrave objekt kontrate.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës ben shërbimin e transportit dhe shpërndarjes së mallrave në kopshtet dhe cerdhja.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktore është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nenligjore të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar deklaratë për përmbushjen me sukses të kontratave.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira për periudhën e zbatimit të kontratës objektin njësi tregtare për shitjen e ushqimeve e pajisur me Leje-Higjenosanitare ose nëse është me qira duhet të paraqesin kontratën e qirase të vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës dhe të figurojë e regjistruar në **QKB** si aktivitet. Për këtë OE duhet të paraqesë:

a) Kontraten noteriale (huapërdorje, ose të qirase)

b) Leje higjeno-sanitare/Akt miratimi higjeno-sanitar për ambientin/objektin

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me liçence lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit me kategorite e mëposhtme:

1. Prodhim përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë.

2. OE duhet të disponojë Njësi tregtimi të ushqimeve me origjinë shtazore e cila duhet të disponohet me një kontratë bashkëpunimi/furnizimi të vlefshme përgjatë zbatimit të kontratës.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pikë 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” pasi gjykohet e nevojshme nga AK për të siguruar në cilësinë e mallit që ofron operatori ekonomik..

2.3.5. Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin çertifikatë të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë:

a) Çertifikatë që garanton sigurinë e ushqimeve **ISO 22000:2018** (ose ekuivalente me të), të lëshuar nga organet kompetente.

Argumentimi :

Kërkohej për të garantuar që operatori ekonomik ka procedurë të standardizuar për:

- planifikim,
- prodhim / ofrim shërbimi,
- kontroll cilësie,

- trajtim ankesash dhe mospërputhjes.

Per plotesimin e kriterit te mesiperm te pikes eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

I. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njësia referuar relacionit të përlllogaritjes së fondit limit përcaktoi kohëzgjatjen si më poshtë:

-Afati i marrëveshjes kuadër 12 muaj

NJESIA E PROKURIMIT